



SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

PUNONJËS ME KOD PUNE

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Urdhërit të Kryetarit nr.15, datë 15.01.2025 për "Miratimin e Strukturës Organizative së Institucionit të Bashkisë Përmet", Bashkia e Përmetit shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira si më poshtë:

1-Shofer në Njësinë e Pastrimit (1 vend)

2-Punonjës Pastrimi në Njësinë e Pastrimit (1)

3-Punonjës Mirembajtje në Njësinë e Mirëmbajtjes (2)

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të kenë të kryer nivelin minimal të diplomës arsimin e mesëm;
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
4. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim;
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
4. Çertifikatë e përbërjes familjare;
5. Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
6. Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
7. Fotokopje e librezës së punës.
8. Raport mjeko-ligjor;
8. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në zyrën e Protokollit , pranë Bashkisë Përmet brenda datës **12.09.2025, ora 12:00.**

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Përmet do të shpallë fituesit në faqen e internetit të Bashkisë Përmet, në stendat e informimit të publikut, në Njësitë Administrative dhe pranë Bashkisë Përmet.

Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Përmet. Afati i ankimit është **3 ditë** nga data e shpalljes së fituesit.

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

